



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1
- Objektet e gjykatave dhe parcela të tokave në vlerë 2,037,278€, të cilat nuk janë në shfrytëzim nga KGJK, ishin prezantuar në regjistrat e pasurisë kapitale në SIMFK, duke e mbivlerësuar vlerën e pasurisë kapitale mbi 1,000€ të raportuar në PFV;
 - Regjistri i pasurisë kapitale mbi 1000€ ishte nënvlerësuar për 9,701€, për shkak të mos regjistrimit të blerjeve të vitit;
 - Vlera e pasurisë jo kapitale nën 1,000€ e raportuar në PFV prej 789,468€, ishte nënvlerësuar për shkak të mosevidentimit në regjistra të pasurisë prej 82,075€ dhe përlllogaritjes së shpenzimeve të zhvlerësimit më shumë se sa duhej për 46,576€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Këshillit Gjyqësor të Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A2 KGJK kishte bërë mbipagesë në vlerë prej 5,664€, si rezultat i pranimit të pajisjeve ndryshe nga ato të kontraktuara.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Sekretariatit dhe Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Sekretariatit dhe Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i KGJK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me pesë rekomandime, prej tyre katër janë rekomandime të reja dhe një është i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mbivlerësim dhe nënvlerësim i pasurive kapitale dhe jo kapitale

Gjetja

Rregulla MF-02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare në Organizata Buxhetore, Neni 6, pika 3 përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria". Më tutje, neni 22, pika 1, e kësaj rregullore, specifikon se, zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë.

Regjistri i pasurisë kapitale në KGJK ishte mbivlerësuar për 2,037,278€, për shkak se në regjistër ishin të përfshira gjashtë objekte dhe katër parcela të tokave, të cilat nuk janë në shfrytëzim nga KGJK por janë bartur për shfrytëzim tek institucione të ndryshme të nivelit qendror dhe lokal. KGJK kishte bërë kërkesë në Ministrinë e Financave për shlyerje të këtyre pronave nga regjistri i saj, mirëpo deri tani kjo shlyerje e pasurive ende nuk ka ndodhur. Nga ana tjetër, regjistri i pasurisë kapitale ishte nënvlerësuar për 9,701€, për shkak të mos regjistrimit të pagesës për rregullimin e autoparkut të KGJK-së.

Regjistri i pasurisë jokapitale ishte nënvlerësuar për 19,227€ (vlera blerëse 24,286€) pasi që 46 pajisje të teknologjisë informative të blera në vitin 2021 nuk ishin reflektuar në këtë regjistër. Nga ana tjetër, për pajisjet e TI që ishin pjesë e regjistrit, shpenzimet e zhvlerësimit ishin kalkuluar për 46,576€ më shumë se sa që duhej, duke e nënvlerësuar vlerën e pasurisë në PFV për këtë vlerë. Më tutje, ne nuk kemi parë se janë regjistruar edhe pasuri jokapitale në vlerë 62,848€, të cilat ishin raportuar si pasuri të paeventuara në regjistrin e e-pasurisë në raportin tonë të vitit 2020.

Vlera e pasurisë jo kapitale e cila ishte prezantuar në PFV, bazohej në raportet nga procesi i inventarizimit të pasurisë jo financiare për vitin 2021. Për qëllime të kalkulimit të zhvlerësimit, data e blerjes së të gjitha pajisjeve ishte vendosur data kur gjatë vitit 2021, ishte kryer inventarizimi në njësitë

përkatëse dhe jo data reale e blerjes së këtyre pasurive. Për më tepër, norma e aplikuar e zhvlerësimit ishte normë e përgjithshme prej afro 72% dhe nuk bazohej në llojin e pajisjes. Për shkak të pamundësisë së sigurimit të të gjitha dëshmive për të identifikuar datën e saktë të blerjes, ne nuk mund të kalkulojmë me saktësi vlerën e gabimit, mirëpo, nga analizat tona kemi identifikuar që gabimi është i rëndësishëm por jo material.

E gjithë kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme joadekuate në lidhje me regjistrimin dhe raportimin e pasurisë.

Ndikimi

Përfshirja në regjistër e pasurive që nuk janë në shfrytëzim të KGJK-së ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë, derisa mos regjistrimi i blerjeve dhe mosaplikimi i saktë i zhvlerësimit ka ndikuar në nënvlerësim të vlerës së pasurisë në regjistrat kontabël. E gjithë kjo ka rezultuar në pasqyrim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV dhe rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet.

Rekomandimi A1

Kryesuesi i KGJK-së në bashkëpunim me Thesarin dhe Institucionet shfrytëzuese të pronave duhet të sigurojë që pasuritë që nuk shfrytëzohen nga KGJK-ja të barten tek institucionet që ju takojnë. Gjithashtu të siguroj që blerjet e pasurisë kapitale dhe jokapitale të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë, në mënyrë që të mundësohet regjistër i plotë i pasurisë dhe raportim i drejtë në PFV. Më tutje, të sigurohet se zhvlerësimi i këtyre pasurive do të bëhet duke përdorur normat e zhvlerësimit e përcaktuara me rregullore, varësisht nga koha reale e blerjes së këtyre pajisjeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Mbi pagesë si rezultat i pranimit të pajisjeve ndryshe nga ato të kontraktuara

Gjetja Rregulla financiare nr.01/2013/MF, për shpenzimin e parasë publike, neni 25, parasheh se para së të regjistrohet shpenzimi në SIMFK, zyrtari përgjegjës duhet të siguroj që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur dhe janë zbatuar të gjitha nivelet e kontrollit të brendshëm financiar.

Për projektin "Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore Prishtinë, dega Fushë Kosovë", në vlerë 744,251€, KGJK kishte paguar vlerën 11,800€ për dy pompa termike "ajër- ujë" me kapacitet 15.8kw, por në vend të tyre, kishte pranuar një pompë me kapacitet prej 32kw. Si rezultat i ndryshimit të pozicioneve ndërmjet pompave të paguara (sipas specifikave të kontratës) dhe pompës së pranuar, KGJK kishte paguar më shumë 5,664€. Për më tepër, kompania në ofertën e saj, ishte zotuar se do i sjellë pajisjet nga kompania ITTAP-Itali, ndërsa pajisjet e pranuarra i përkasin brendit Grohod. Vlen të përmendet fakti se KGJK pas marrjes së draft raportit të auditimit, kishte ndërmarrë masa për zëvendësimin e pompave sipas pagesës dhe kontratës.

Kjo kishte ndodhur për shkak se, KGJK në mungesë të kapaciteteve të brendshme mbikëqyrjen e punimeve e kishte kontraktuar nga një kompani e jashtme. Edhe pse për monitorimin e këtij projekti ishte caktuar edhe menaxheri i kontratës, i njëjti nuk e kishte vërejtur këtë devijim nga kontrata. Në diskutim me kompaninë mbikëqyrëse, ky ndryshim pozicioni është arsyetuar me faktin se nga aspekti i kapaciteteve në kw, pompa e madhe e pranuar, i zëvendëson dy pompat e vogla.

Ndikimi Shpenzimet për mallrat e papranuar janë në kundërshtim me rregulloren për shpenzimin e parasë publike, dëmtojnë buxhetin dhe ndikojnë në mos arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi A2 Kryesuesi i KGJK-së duhet të rris mbikëqyrjen për të gjitha nivelet e kontrollit financiar dhe pagesat të bëhen vetëm për mallrat e pranuarra në bazë të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 16,314,550€, e pasurive jokapitale është 789,467€, si dhe e stoqeve 85,642€. Kemi testuar 85 mostra për teste substanciale në vlerë 6,226,195€, si dhe kemi bërë teste të pajtueshmërisë.

Çështja B1 - Dobësi në mbajtjen e regjistrave për pasuri nën 1,000€ dhe stoqeve

Gjetja	<p>Sipas rregullores MF -nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6, pika3, pasuria jo kapitale e dhe stoqet, duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Më tutje neni 19, pika 4.3, e kësaj rregullore, specifikon se, komisioni i inventarizimit duhet të bëjë krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.</p> <p>Sistemi i e-pasurisë nuk ishte aplikuar nga KGJK për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë jo kapitale dhe stoqeve. Për më tepër, KGJK nuk kishte mbajtur as regjistra të brendshëm për evidentimin e pasurisë jo kapitale. Vlera e pasurisë jo kapitale 789,468€ dhe vlera e stoqeve 85,642€ e cila ishte prezantuar në PFV, ishte bazuar në raportin e inventarizimit të cilin e kishte bërë komisioni në fund të vitit. Duke qenë se nuk kishte regjistër të pasurive jo kapitale, komisioni i inventarizimit nuk ka mundur të bëjë harmonizimin gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive.</p> <p>Dobësitë e identifikuar në menaxhimin e pasurive jo kapitale kanë ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme, mungesës së komunikimit, si dhe mos funksionimit të sistemit E-pasuria.</p>
Ndikimi	<p>Mos mbajtja e regjistrave të pasurisë jo kapitale dhe stoqeve, si dhe mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël reflekton në mbivlerësim/nënvlerësim të informatave mbi gjendjen e pasurisë. Kjo rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet dhe njëherësh ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.</p>
Rekomandimi B1	<p>Kryesuesi i KGJK-së duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pasurisë dhe nëpërmjet Administratorëve të Gjykatave, duhet të sigurojë se pasuritë jokapitale regjistrohen në regjistra përkatës sipas kërkesave ligjore. Poashtu duhet siguruar krahasimi i gjendjes së pasurisë sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të reflektohen ndryshimet eventuale në PVF.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2021, ishte 47,302,352€. Ne kemi testuar 29 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 43,462,873€. Këto detyrime kanë të bëjnë me paditë e ndryshme nga personat të cilët ishin privuar nga liria po më vonë ishin shpallur të pafajshëm si dhe me padi të tjera lidhur me mos pajtimin e palëve për vendimet e Gjykatave përkatëse.

Çështja A3 - Nënvlërësimi i detyrimeve kontigjente

Gjetja

Sipas rregullores së MF - nr. 01/2017 Për raportim vjetor financiar, neni 18, parasheh që organizatat buxhetore në harmoni LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Në tri raste, vlera e detyrimeve kontigjente nuk ishte llogaritur saktë, pasi që në këtë vlerë nuk ishin përfshirë të gjitha detyrimet të cilat dalin nga paditë. Si rezultat i kësaj, vlera e detyrimeve kontigjente e raportuar në PFV është nënvlerësuar për 13,814€.

Kjo kishte ndodhur nga mungesa e kontrolleve nga menaxhmenti dhe pakujdesia e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi

Nënvlërësimi i vlerës së detyrimeve kontigjente ndikon në prezantimin jo të saktë dhe të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi A3

Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin e detyrimeve kontigjente në mënyrë që të mundësohet regjistër i saktë i detyrimeve kontigjente dhe raportim i drejtë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm në kuadër të Këshillit Gjyqësor funksionon me katër anëtar duke përfshirë edhe Drejtorin e saj. Për vitin 2021 NJAB kishte të planifikuara 10 auditime dhe aq ishin përfunduar. Kjo njësi kishte raportuar në Njësinë Qendrore Harmonizuese sipas kërkesave të parapara.

Çështja A4 - Mos funksionimi i komitetit të auditimit

Gjetja

Udhëzimi Administrativ MF- Nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 8, përcakton që takimet e Komitetit të Auditimit duhet të mbahen së paku katër (4) herë në vit.

Gjatë vitit 2021, Komiteti i Auditimit kishte mbajtur vetëm një takim në tremujorin e dytë, derisa në fund të vitit, i njëjti ishte shpërbërë tërësisht. Menaxhmenti kishte formuar komitetin e ri të auditimit me 31.12.2021.

Sipas personave përgjegjës, mos mbajtja e takimeve ishte rezultat i rrethanave pandemike dhe poashtu edhe shkak i dorëheqjes së anëtarëve të komitetit në fund të vitit.

Ndikimi

Mos funksionimi i plotë i KA mund të rrezikojë cilësinë e punës së NJAB dhe rrjedhimisht sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontroleve kyçe financiare, me ndikim edhe në nxitjen e menaxhmentit për të zbatuar rekomandimet e auditimit.

Rekomandimi A4

Kryesuesi i KGJK-së duhet të stimuloj dhe mbështesë punën e komitetit të auditimit për t'u siguruar se roli dhe misioni i tij në organizatë po përmbushet dhe funksioni i auditimit të brendshëm është i monitoruar mirë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	29,194,592	28,468,556	28,028,490	27,080,416	28,529,735
Grante Qeveritare - Buxheti	27,503,334	26,490,384	26,363,280	25,602,096	26,753,166
Të bartura nga viti i kaluar	0	256,350	0	0	0
Të hyrat vetanake	1,691,258	1,691,258	1,644,349	1,434,908	1,638,087
Donacionet e jashtme	0	30,565	20,861	43,412	138,482

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 726,036€. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit të ligjit të buxhetit dhe vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2021 OB ka shpenzuar 98% të buxhetit përfundimtar ose 28,028,490€ me një përmirësim 2% në krahasim me vitin 2020.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	29,194,592	28,468,556	28,028,490	27,080,416	28,529,735
Pagat dhe mëditjet	24,166,766	23,290,742	23,277,174	23,300,383	23,684,488
Mallrat dhe shërbimet	3,407,826	3,557,732	3,491,931	2,901,150	3,760,544
Komunalitë	350,000	330,733	328,195	287,389	319,449
Subvencionet dhe transferet	500,000	756,350	457,501	243,650	456,814
Investimet Kapitale	770,000	533,000	473,689	347,845	308,441

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte zvogëluar për 876,024€. Ky ndryshim ishte rezultat i zvogëlimit prej 906,042€ me vendim të qeverisë dhe pranimit të donacioneve në vlerë 30,018€.


Buxheti përfundimtar, në raport me buxhetin fillestar për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 149,906€. Ky ndryshim ishte si rezultat i vendimeve të qeverisë për bartje të mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë 137,000€, pastaj vendimit për shkurtime buxhetore prej 701€, dhe në fund të vitit, vendimit për rritje të buxhetit prej 13,607€.

Buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar për kategorinë e shpenzimeve komunale ishte zvogëluar për 19,267€, si rezultat i shkurtimeve buxhetore në fund të vitit me vendim të qeverisë.

Buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ishte rritur për 256,350€. Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti paraprak.

Buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar për kategorinë e investimeve kapitale ishte zvogëluar për 237,000€. Ky zvogëlim ishte bërë fillimisht me rishikim të buxhetit ku ishte reduktuar buxheti për 100,000€ dhe pastaj bartjes së mjeteve në vlerë 137,000€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve sipas vendimit të qeverisë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Këshilli Gjyqësor në 2021 ishin në vlerë 9,019,139€. Ato kanë të bëjnë me gjobat e trafikut, gjobat nga gjykatat, taksat gjyqësore, taksat për kompensimin e viktimave të krimit, gjobat dhe taksat nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Krahasuar më vitin paraprak kemi rritje të të hyrave për 2,976,287€ apo 49%. Kjo rritje ka të bëjë me rritjen e numrit të lëndëve të zgjidhura nga ana e gjykatave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	6,959,118	7,718,557	9,019,139	6,042,852	7,608,314
Të hyrat jo tatimore	6,959,118	7,718,557	9,016,883	6,042,371	7,602,279
Të hyrat tjera	0	0	2,256	481	6,035

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 të Këshillit Gjyqësor ka rezultuar me tre rekomandime kryesore. KGJK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, dy rekomandime janë zbatuar, ndërsa një rekomandim nuk është zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të sigurohet që komisioni i inventarizimit para përgatitjes së PFV të bëj inventarizimin e të gjitha pasurive në KGJK dhe të përgatis raportin që ndërlidhet me procesin e inventarizimit.	KGJK kishte kryer procesin e inventarizimit nëpër të gjitha njësitë e sajë.	I zbatuar
2.	Pasuritë	Kryesuesi i KGJK-së nëpërmjet Administratorëve duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistra përkatës në mënyrë që të ketë një menaxhim dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Nga rezultatet e auditimit të këtij viti, kemi verifikuar se gjendja është e njëjtë. (Ref. Çështja A1)	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës duhet të ndërmarr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara në bazë të faturimeve dhe që vlera e tyre shpaloset saktë në PFV duke u bazuar në shënimet e softwerit për të hyrat gjyqësore (SEMH).	KGJK kishte shpalosur saktë vlerën e llogarive të arkëtueshme.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit




Pleurat Isufi, Udhëheqës i ekipit




Qëndresa Isufi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL


Prishtinë - A

LETËR KONFIRMIMI

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve


Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem**/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Albert Zogaj
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Data: 16 maj 2022, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.